



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORATI

Nr. 300 Prot.,

Datë 01/02/2021

VENDIM

Nr. 1 datë 01/02/2021

“MBI MËNYRËN E ZHVILLIMIT TË PROVIMEVE TË SEMESTRIT TË PARË NË  
UNIVERSITETIN E TIRANËS”

Në mbledhjen e datës 01/02/2021, Rektorati i Universitetit të Tiranës, bazuar në nenin 40, pika 4, të Ligjit 80/2015; neni 36, pika 3 dhe 4, të Statutit të UT-së,

VENDOSI:

1. Provimet e semestrit të parë do të zhvillohen online.
2. Provimet të cilat nuk mund të zhvillohen online për shkak të specifikës së lëndës, me kërkesë të titullarit të lëndës dhe me miratim paraprak të përgjegjësit të njësisë bazë, do të zhvillohen në auditor pasi të merret vendimi nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe nga Komiteti Teknik i Ekspertëve, i ngritur për monitorimin e situatës së krijuar nga virusi SARS-COV 2.
3. Në rast se, Komiteti Teknik i Ekspertëve nuk miraton kërkesat e zhvillimit të provimeve për këto lëndë në auditor, titullarët e tyre të shohin mundësitë alternative të përmbylljes së procesit të provimeve në këtë semestër.  
Në pamundësi të realizimit të këtyre provimeve brenda këtij semestri si dhe për ata studentë që kanë pamundësi të pjesëmarrjes në këtë semestër do të përcaktohet një periudhë e mëvoshme e zhvillimit të tyre brenda muajit qershor.
4. Njësitë kryesore, për të komunikuar më tej me Komitetin Teknik të Ekspertëve, brenda datës 03/02/2021, të dërgojnë në Rektorat lëndët, provimet e të cilave kërkohet të zhvillohen në auditor.
5. Ky vendim u përcillet për zbatim të gjitha njësive përbërëse të UT-së.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

PROF. DR. ARTAN HOXHA

